

“Mjedisi Sot”
Nr 2205 E Hene 01/10/2007

Pergatitur nga Qendra Rajonale e Mjedisit
Rr. Ismail Qemali, Nr. 27, Kati III
Kutia postare 127, Tirane
Tel/Faks (+355 4) 23 29 28
Email: info@albania.rec.org
Web: <http://albania.rec.org>
www.mjedisisot.info

PERMBAJTJA

NGA VENDI

- Hapet qendra e aarhusit shkoder
- Fier, 700 gjahtare proteste kunder ministrit xhuveli
- Shkoder, mbeturinat mbulojne varrezat e deshmoreve
- Posta shekulli: "ndotja e ajrit, po i hapim varrin vetes perdite"
- Durresi leshon sos nga trekendeshi i frikshem i ndotjes

NGA BOTA

- Hungaria i bashkohet partneriteti per energjine e rinovueshme
- Gjermania do te promovojë planin per kapjen e karbonit

Njoftime

- Promovohet faqja e internetit e qendres se informacionit aarhus
- RESILIENCE 2008 - Resilience, Adaptation and Transformation in Turbulent Times

Te gjitha OJF-te mjedisore dhe ato qe kryejne aktivitete per mjedisin, jane te mirepritura te dergojne informacione ose njoftime, ne adresen ‘Mjedisi Sot’ info@albania.REC.org, ose Kutia

Postare 127, Tirane.

Pergatitja e lajmeve ditore eshte mundesuar ne saje te mbeshtetjes nga Agjencia Spanjolle per Bashkepunim Nderkombetar – AECI.

Nga VENDI

HAPET QENDRA E AARHUSIT SHKODER

Buletini i Ministrise se Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit te Ujerave, shtator 2007

Nen Kujdesin e OSBE-se dhe Ministrise se Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit te Ujerave ne bashkepunim dhe me Bashkine e Shkodres me 20 Shtator 2007 u hap Qendra e Informacionit Aarhus. Kjo qender tashme ka ne dispozicion te publikut te interesuar nje kompjuter me akses interneti, ku publiku i interesuar mund te informohet per problem te ndryshme te mjedisit. Gjithashtu kjo qender do te sherbeje si nje ure lidhese mes autoriteteve lokale, agjensise se mjedisit dhe Shoqerise Civile.

Ne kete ceremoni ishin te pranishem perfaqesues nga Ministria e Mjedisit, Nenkryetari i Bashkise Z. Ridvan Troshani, Prefekti i Shkodres Z. Maxhit Cungu, Drejtori i Agjensise Rajonale te Mjedisit Shkoder Z. Liljan Idrizi, perfaqesues nga OSBE Prezenca ne Shqiperi Z. Robert Mangham, Kryetari i Njesise Ekonomike dhe Mjedisit, perfaqesues nga OSBE Zyra Shkoder, perfaqesues nga OJF-te, krytare te Njesive Administrative si dhe nga perfaqesues nga komuniteti.

Ky inagurim vjen pas nje trajnimi dy ditor qe u organizua nga OSBE me pjesemarrje nga pushteti lokal dhe shoqerise civile, por me nje shtrirje te gjere edhe nga Puka e Malesi e Madhe dhe komuniteti perreth Shkodres.

Fier, 700 gjahtarë proteste kundër ministrit Xhuveli

Irma Hoxha, Gazeta Shqiptare, fq. 24

Gjahtarët e Fierit, Lushnjës, Beratit, Durrësit e të Tiranës, janë organizuar në mënyrë demonstrative duke tentuar të futen në një zonë, në të cilën, me një vendim të Ministrisë së Mjedisit, ndalohej gjuetia. Dy net me parë, rreth orës 01:00, gjahtarët kanë tentuar të futen në zonën e Godullës, në Libofshe të Fierit. Organizimi i tyre ka alarmuar Drejtorinë Pyjore, e cila ka thirrur për ndihmë Policinë e Rendit për të perballuar gati 700 gjahtarë nga shumë rrethet e vendit. Ata, në mënyrë demonstrative kanë kundërshtuar vendimin e dikasterit të Mjedisit. Turma është shpërndarë vetëm të nesërmen, pas debateve dhe pakenaquesive që kanë bërë të ditura vete gjahtarët. Gjithçka ka ardhur nga mungesa e theksuar e dëshirës së Shoqatës së Gjuetarëve për të bashkëpunuar me Ndermarrjen Pyjore. Edhe pse herë pas here gjahtarët janë njoftuar nepermjet shoqatës së tyre për zonat e lira dhe të ndaluara të gjuetisë, mesa duket ende nuk ka një ndërgjegjesim të tyre.

Godulla

Godulla është një nga zonat për të cilën, ministri i Mjedisit, Luftër Xhuveli ka leshuar vitin e kaluar një urdher për ndalimin e gjuetisë. Godulla ndodhet në komunën Libofshe të rrethit Fier dhe ka në qendër të saj një minilagunë, rreth së cilës grumbullohen shumë shpeze të egra. Për masivitetin e tyre edhe gjuetia në këtë zonë është me e lakmuar. Pikerisht për demtimet e medha që ndodhin nga kjo gjueti masive dhe frika e një shterimi të shpendeve të egra, kanë bërë që ministri Xhuveli ta ndalojë gjuetinë në Godull por edhe në një sipërfaqe rreth 1 km larg saj. Mirepo, një vendim i tillë mesa duket nuk është kuptuar nga gjuetarët dhe shoqatat e tyre. Qysh herët në mëngjes, ata janë ndeshur me Policinë Pyjore dhe atë të Rendit. Gjuetarët ishin organizuar qysh një ditë më parë nepermjet

shoqates se tyre dhe kishin lene piken e takimit per hapjen e gjuetise pikerisht ne zonen e ndaluar te Godulles. Rreth ores 01:00 te mengjesit te se dieles, ata jane grumbulluar grupe-grupe ne kete zone. Brenda nje ore, aty jane mbledhur rreth 700 gjahtarë jo vetem nga Fieri dhe fshatrat e tij, por dhe nga Durresi, Tirana etj. Pikerisht aty i kane pritur Policia Pyjore, ajo e Rendit dhe grupi i gatshem, te cilet kishin marre informacion me pare per organizimin e paligjshem te gjahtarëve.

Konflikti

Sipas drejtuesit te Ndermarrjes Pyjore, Saimir Hoxha, jane kryer te gjitha njoftimet e nevojshme ne adrese te Shoqates se Gjuetareve per zonen e ndaluar te Godulles. Sipas Hoxhes, i eshte lene si detyre sekretarit te kesaj shoqate, Pandeli Mone qe te bente njoftimet tek anetaret e saj. Por sipas vete gjuetareve, ata nuk kane marre asnje njoftim nga sekretari i tyre Mone, por jane njoftuar vetem per celjen e sezonit te gjuetise dhe asgje me teper. Per 12 ore rresht, prania e gjuetareve ne kete zone ka detyruar qe te qendrojne roje dhe ne gatishmeri te plote gjithe efektivet e Ndermarrjes Pyjore. Sipas kreut te Pyjores, gatishmeria dhe ruajtja e zonave te ndaluara do te jete nje nga prioritetet e ketij sezoni gjuetie, pavaresisht se ata nuk ndihmohen nga drejtuesit e shoqatave te gjuetise. Nderkaq, gjahtarët kane kerkuar te vijojne punen e tyre, pasi pretendojne se kane plotesuar te gjitha dokumentet e nevojshme dhe nuk u duket e arsyeshme mbajtja peng e nje zone te tille sic eshte Godulla.

Shkoder, mbeturinat mbulojne varrezat e Deshmoreve
Anila Dushi, gazeta Shekulli, fq. 7

Mungesa e nje vendi te pershtatshem per grumbullimin e mbeturinave ne Shkoder po sjell, jo vetem mbulimin e varrezave te deshmoreve, vend ku hidhen mbetjet, por edhe protesta te banoreve. Drejtuesit e bashkise kane kerkuar me ngulm financim nga shteti per zbatimin e nje projekti per kete qellim, projekt ky qe kap nje vlere prej 70 milione leke te reja. Por ndonese projekti per ngritjen e nje vendi depozitimi mbeturinash urbane dhe perpunimi te tyre, eshte gjendur ne Bushat eshte bere projekti dhe dhene lejet perkatese, madje dhe nga KRRT e Republikes, mungesa e financimit te tij ka bere qe problemi te mos gjeje akoma zgjidhje. Mbeturinat urbane te qytetit vazhdojne te hidhen tek varrezat e deshmoreve, vend qe megjithese i tejmbushur vazhdon te prese serish plehra. Nderkohe qe vendet provizore te gjetura pak metra me tej, jane gjithashtu plot. Pas kesaj, prej ditesh mjetet e ndermarrjes se pastrimit te qytetit, plehrat i hedhin perseri tek varrezat e deshmoreve. Madje per te liruar vend digjen mbeturinat ekzistuese. Pasojat bien mbibanoret e lagjeve "Mark Lula", "Tre Heronjte" dhe Tepe ne Shkoder. Banoret jo rralle here kane protestuar per kete dhe madje kane arritur te bllokojne edhe rrugen tek vendi i quajtur Ura e Trenit, per te mos lejuar makinat e ndermarrjes se pastrimit per te shkarkuar mbeturinat. "Fusha prane varrezave te deshmoreve, ngjitur me rrugen nacionale Shkoder-Puke, eshte e tejmbushur. Edhe pas ngjeshjes se mbeturinave urbane me makinat perkatese, perseri vendi vazhdon te mbushet dhe ne keto kushte per te liruar vend behet djegia e tyre",- thone banoret qe numerojne me radhe vuajtjet nga afersia me plehrat. "Ne mes te veres kemi ndenjur me dyer e dritare mbyllur, per te shpetuar nga tymi qe ngrihej si re",- thote Gjon Mhillaj. Banoret thone se djegia e ketyre mbeturinave po shkakton semundje, ne menyre te vecante te femijet. Gjon Mhillaj, Gjoke Leka, Pjeter Kola e te tjere banore qe i takon ne kete zone, tregojne sesi tymi qe clirohet nga djegia e mbeturinave perfshin nje vije ajrore mjaft te gjere, shkon deri tek pallatet ne lagjen Tepe, apo tek banesat e Bardhajve. "Kane filluar qe tani te shfaqen semundjet kjo dhe tek mjaft femije, por pasojat do jene me te renda ne te ardhmen. Ne vazhdojme te thithim ajrin e ndotur qe shkaktojne keto mbeturina te djegura ose jo, ndersa askush nuk ia ve veshin ketij halli qe na ka gjetur",- thone ata. Per bashkine e Shkodres, nuk ka asnje mundesi financiare per te nderhyre, ndersa sipas tyre eshte shteti

ai qe duhet t'i jape zgjidhje sa me pare ketij problemi.

posta shekulli: "Ndotja e ajrit, po i hapim varrin vetes perdite"
Gazeta Shekulli, fq. 18

Sipas statistikave 150 vete ne Tirane vdesin nga kanceri ne mushkeri cdo vit, kohet e fundit. Ajrin e ndotur te Tiranes tashme e kemi te gjithë para syve. Po te ngjitesh lart ne Dajt dhe te hedhesh nje sy ne ore darke ne Tirane habitesh se si ka mundesi te jetojne njerez ne ate pisllek? Nje grope e madhe, ose me mire ta quaj, nje varr qe ia hapim cdo dite vetes. Ajri i ndotur ka edhe efekte te tjera te mevonshme: Ai krijon re te atilla qe kur bie shi, e quajne shiu acid, pasi eshte me permbajtje te elementeve te cilluar nga keto tymra.

Shiu acid eshte dhe shkaktar per korrozionin e makinave, pallateve, hekurave, pemeve dhe cdo gje tjeter te ekspozuar jashte ne ambient. Kjo eshte vec maja e ajsbergut pasi ndotjet vijne dhe nga pluhuri i rrugeve apo ndertimeve dhe sipas statistikave, ne nje vit, njeriu thith 35 kg pluhur ne mushkerite e tij = 2.9 kg ne muaj = afro 100 gram pluhur cdo dite. Meqenese qeverite jane te paafta te ulin sasine e ndotjes nga makinat, i ngelet pergjegjesia vete qytetareve te ecin me shume me bicikleta dhe me kembe (shembull: Shkodra) sesa te presin rritje taksash dhe te cmimit te karburantit per t'i ndergjegjesuar ata jo vec nga ana ekonomike, por dhe nga ajo shendetesore.

DURRESI LESHON SOS NGA TREKENDSHI I FRIKSHEM I NDOTJES
Oerd Ulqini, gazeta Panorama, fq. 10

“Durrresi eshte ne SOS mjedisor”. Ish ndermarrja e pesticideve te Porto Romanos, hidrovori dhe masivi i plehrave jane kthyer ne “fabrikues” te vdekjes.

Ky eshte konkluzioni i specialisteve te mjedisit ne Durres. Sipas tyre, efekti i gazrave toksike qe clirohen nga djegia e plastikes, ka pasoja neuroparalizuese te komuniteti. Gazi i frikshem nervin, i cili klasifikohet si arme e demtimit ne mase ka karakteristika te njejta me ato qe emetohen mbi periferine e Durresit. “Ky gaz sjell djegie te syve, paralizim te sistemit nervor dhe crregullime psikike”, shprehen specialistet mjedisore. Sipas inxhinierit kimist, Vlash Grami, “trekendeshi” i helmeve ne Porto Romano eshte shnderruar ne nje arme tipike te demtimit ne mase per banoret. Kjo nuk eshte nje shprehje e thene vetem ne kuptimin figurativ. Grami, nje inxhinier i specializuar per ceshtjet e mjedisit, argumenton se nga djegia e lendeve plastike dhe e mbetjeve te tjera ne Porto Romano emetohen gazra qe demtojne rende trurin. Nga plehrat clirohet ne ajer karbon, hidrogjen, azot, sqfur e te tjera lende si keto. Nga emetimet e tyre dalin vecanerisht oksidet e azotit dhe gazra sulfurore. Si pasoje e djegies se plastikes, clirohen ne atmosfere gazrat me helmues per popullaten, ekuivalente me gazrat e llojit nervin, lende e cila perdoret ne ushtri si arme kimike...

NGA BOTA

Hungaria i bashkohet partneriteti per energjine e rinovueshme
ENDS Europe DAILY 2394, 25/09/07

Hungaria eshte bere vendi i 35-te pjesetar i Partneriteti nderkombetar per energjine e rinovueshme dhe eficencen energjitike (Reeep), behet e ditur sot.

Reeep, me qender ne Viene, eshte nje partneritet publik-privat qe nxit promovimin e politikave per

energji e rinovueshme dhe eficencen energjitike. Hungaria eshte vendi i dyte i Evropes lindore, i cili angazhohet ne kete partneritet, pas Rumanise ne vitin 2006. Vende te tjera qe u angazhuan ne kete partneritet vitin e kaluar ishin Zvicra, Argjentina, Singapori dhe Tunizia.

Per me shume informacion:

<http://www.reeep.org/>

GJERMANIA DO TE PROMOVOJE PLANIN PER KAPJEN E KARBONIT ENDS Europe DAILY 2391

Qeveria gjermane ka bere te ditur se do te nxise zhvillimin e teknologjive per kapjen dhe depozitimin e karbonit per stacionet energjitike te qymyrit dhe gazit, duke parashikuar qe keto teknologji do te jete ne funksionim deri ne vitin 2020-te. Qeveria shprehet se ajo do te pergatite terrenin ligjor per te siguruar ndertimin e qendres R&D si dhe te uzinave te pajisura me teknologjine per kapjen dhe depozitimin e karbonit.

Ne deklaraten e qeverise nuk eshte permendur asnje mbeshtetje financiare.

Per me shume informacion:

http://www.bundesregierung.de/nn_1264/Content/DE/Artikel/2007/09/2007-09-19-ccs-technologien.html

Njoftime

PROMOVHET FAQJA E INTERNETIT E QENDRES SE INFORMACIONIT AARHUS

Qendra e Informacionit Aarhus, ne date 03.10.2007 ora 10.30, ne mjediset e Ministrise se Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit te Ujerave (Salla e Mbledhjeve), organizon Prezantimin e faqes se re te internetit te Qendres se Informacionit Aarhus: www.aic.org.al

Te gjitha te interesuarit ftohen te marrin pjese ne kete promovim.

Per me shume mund te kontaktoni:

Edlira Dersha

Qendra e Informacionit Aarhus

Tel/fax ++355 4267341

e-mail: edersha@moe.gov.al

RESILIENCE 2008 - Resilience, Adaptation and Transformation in Turbulent Times International Science and Policy Conference, Stockholm, Sweden, April 14-17 2008.

Background information:

Resilience 2008 aims to be more than a regular science conference. On the agenda in Stockholm are plenary sessions, core and short paper sessions, panel and working group sessions, poster sessions, but also open space and futures sessions, a policy forum, a resilience inspired art exhibition and musical performances.

Who is the conference for?

The conference will bring together scientists who work on the complex dynamics of social-ecological systems, to present, discuss, and summarise the current understanding of resilience, adaptability and pathways of transformation in systems of humans and nature. Representatives from government, business and other major actors will be invited to the policy forum to discuss the challenges facing societal development, and together with scientists propose directions to go and pathways to avoid. To explore this further there will be an art exhibition on resilience issues in cooperation with the Royal Swedish Academy of Fine Arts.

Organizers:

Resilience 2008 is organized by the Resilience Alliance in collaboration with the Royal Swedish Academy of Sciences and International Council for Science (ICSU). Local organizers: Stockholm Resilience Centre at Stockholm University, Stockholm Environment Institute (SEI) and Beijer International Institute of Ecological Economics (Conference secretariat).

The themes of the conference:

The overall framework of the Resilience 2008 conference stresses the following features:

- Society and nature represent truly interdependent social-ecological systems
- Social-ecological systems are complex adaptive systems and
- Cross scale and dynamic interactions represent new challenges for governance and management in relation to interdependent social-ecological systems and ecosystem services.

The following overall themes have been proposed to help shed light on the issues, with a few tentative sub-themes to be expanded and further developed during fall 2007.

Abstract submission:

Submission of abstracts for oral and poster presentations will be open from August 15 to November 16. Abstracts must be submitted in English with a maximum word count of 500. Authors will be notified about the outcome of the review process late December 2007.

Further information about the submission will be provided on the conference website www.resilience2008.org

Registration:

Will be open from September 15

Contact:

Christina Leijonhufvud

Mail: chris@beijer.kva.se

www.resilience2008.org

C'eshte "Mjedisi Sot"

"Mjedisi Sot" eshte nje nga botimet periodike te Qendres Rajonale te Mjedisit - Zyra ne Shqiperi. Ne kete botim ditor do te gjeni lajme dhe probleme mjedisore nga shtypi i dites, informacion per aktivitetet mjedisore nga vendi dhe bota.

Per t'u futur falas ne listen e shperndarjes se "Mjedisi Sot" ose per t'u cregjistruar, dergoni nje e-mail

ne adresen: info@albania.REC.org

Versionin e shtypur mujor te "Mjedisi Sot" mund ta gjeni prane Zyres se REC ne Shqiperi.

Lajmet mjedisore ditore dhe "Mjedisi Sot" mujor mund t'i gjeni edhe ne internet: <http://albania.REC.org>

www.mjedisot.info

C'eshte REC

Qendra Rajonale e Mjedisit (REC) per Evropen Qendrore e Lindore eshte nje organizate nderkombetare jopartizane, joavokate, jofitimpruese qe mbeshtet zgjidhjen e problemeve mjedisore ne Evropen Qendrore e Lindore (EQL), duke nxitur bashkepunimin ndermjet organizatave joqeveritare, qeverive, bizneseve e aktoreve te tjere mjedisore, si dhe duke mbeshtetur shkembimin e lire te informacionit dhe pjesemarrjen e publikut ne vendimmarrjen mjedisore.

REC eshte krijuar ne 1990 nga ShBA, Komisioni Evropian dhe Hungaria. Sot REC, bazohet ligjerisht ne Karten e tij, nenshkruar nga 28 vende dhe Komisioni Evropian, dhe ne nje marreveshje nderkombetare me qeverine hungareze. REC ka zyren qendrore ne Szentendre, Hungari dhe zyrat e vendeve ne secilin prej 16 vendeve perfituese. Shqiperia e ka nenshkruar Karten e REC ne 1992. Zyra e REC per Shqiperine eshte hapur ne 1994. Kjo zyre punon per realizimin e misionit te REC duke mbeshtetur organizatat jofitimpruese, institucionet mjedisore ne te gjitha nivelet, dhe aktore te tjere te interesuar ne fushen e mjedisit, duke mbeshtetur proceset pjesemarrese dhe shkembimin e lire te informacionit. Fushat kryesore te veprimtarise jane: Programi i granteve per OJF-te; Planet Lokale te Veprimit ne Mjedis, Informacioni Mjedisor; Edukimi Mjedisor; Programi i kualifikimit per OJF-te dhe zyrtare te mjedisit, nismat dhe programet vendore e rajonale; etj.

Nese jeni te interesuar te njiheni me cfare ndodh cdo dite ne mjedisin shqiptar dhe neper bote, abonohuni falas ne "Mjedisi Sot", pakete e perditshme elektronike. Dergoni nje mesazh me titull "Abonim" tek info@albania.rec.org
